


● **SFIDA**
**„ME TRANSFORMIMIN DIGJITAL
DERI NË INOVACIONE”**



QËLLIMI

Qëllimi i sfidës është rritja e inovacionit, konkurrueshmërisë dhe produktivitetit të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin bujqësor-ushqimor dhe turistik, duke vendosur zgjidhje digjitale që do të çojnë në transformimin digjital në veprimtarinë e tyre. Njëkohësisht, sfida synon të mundësojë përforcimin e kapaciteteve të qendrave të inovacionit digjital si pjesë e ekosistemit të nevojshëm për transformimin e mëtejshëm digjital.

FIZHT e realizon këtë sfidë në partneritet me **Zvicra** përmes **Programit për rritjen e punësueshmërisë së tregut – IME** dhe **INOFEIT DIH**.

- **IME** do të marrë pjesë në buxhetin e përgjithshëm të sfidës me mjete financiare prej **6.150.000** denarë.
- **INOFEIT DIH**, së bashku me Fondin, do të përfshihen në procesin e implementimit të zgjidhjes/zgjidhjeve digjitale të shpërblyera.



ÇFARË ZGJIDHJESH MBËSHTESIM

Me këtë sfidë, ne mbështesim: zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve digjitale që, nëpërmjet transformimit digjital, do të çojnë në zhvillimin e produkteve, proceseve dhe shërbimeve inovative tek ndërmarrjet garuese nga sektorët agro-ushqimor dhe turizmit.

Zgjidhjet digjitale mund të bazohen në inteligjencën artificiale, realitetin virtual, automatizimin, robotikën, internetin e gjërave, zgjidhjet e bazuara në ueb dhe zgjidhje të tjera të transformimit digjital.

Zgjidhjet e përzgjedhura do të prezantohen dhe do të vihen në dispozicion të të rinjve të moshës 15 deri në 25 vjeç, nëpërmjet të paktën një trajnimi falas të organizuar nga Garuesi.

AKTIVITETET E PROJEKTIT

- Aktivitetet për hulumtim dhe zhvillim;
- Prezantim dhe testim të një produkti, shërbimi ose procesi të ri si rezultat i transformimit digjital tek garuesi;
- Dizajnim dhe zhvillim të një zgjidhjeje të re inovative në faza, nga një koncept i konfirmuar në një zgjidhje funksionale në një mjedis real për qëllimet e transformimit digjital të garuesit;
- Prezantim të një zgjidhjeje të re ose mbindërtim të një zgjidhjeje digjitale ekzistuese që do të zbatohet për qëllime të transformimit digjital të garuesit;
- Aktivitete për të shumëfishuar aktivitetet digjitale dhe/ose aktivitetet në mjedise dhe grupe të tjera të synuara;
- Aktivitete që lidhen me mirëmbajtjen e zgjidhjes digjitale, sigurimin e cilësisë, standardizimin dhe akreditimin e një produkti, shërbimi ose procesi tek garuesi;

* Lista e mësipërme e aktiviteteve nuk është kufizuese.

BUXHETI

Mbështetje financiare në shumë prej **18.450.000 denarë**.

FIZHT siguron mjete financiare prej 12.300.000 denarë, ndërsa pjesën tjetër e siguron **Zvicra përmes Programit për rritjen e punësueshmërisë së tregut – IME**.

- ▶ Financim deri në 70% nga buxheti i përgjithshëm për projektin, në shumën maksimale prej 1.845.000 denarë për ndërmarrjet mikro ose të vogla.
- ▶ Financim deri në 50% nga buxheti i përgjithshëm për projektin, në shumën maksimale prej 1.845.000 denarë për ndërmarrjet e mesme.
- ▶ Afati për realizimin e projektit deri në 12 muaj.

KUSH MUND TË APLIKOJË

- Të jetë shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ardhurat vjetore të garuesit nuk duhet të kalojnë 10.000.000 euro në kundërvlerë me denarë, sipas raporteve financiare për dy vitet paraprake fiskale;
- numri mesatar i të punësuarve nuk duhet të kalojë 250 punonjës;
- Nuk është i lidhur (sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare) me një ndërmarrje tjetër dhe/ose OPSH, të ardhurat vjetore të së cilës i kalojnë 10,000,000 euro dhe se numri mesatar i të punësuarve nuk i kalon 250 në dy vitet paraprake fiskale, përveç rastit të lidhjes me një institucion të arsimit të lartë gjegjësisht një institucion kërkimor shkencor;
- ndaj tij nuk është ngritur procedura e falimentimit ose e likuidimit;
- të ketë shlyer detyrimet e vonuara në bazë të detyrimeve dhe kontributeve publike;
- ndaj tij nuk ka filluar procedura për ekzekutimin e detyrueshëm të kërkesave monetare të vonuara;
- Rregullorja e plotë për pranueshmërinë e aplikantit është publikuar në: <https://fitr.mk/digitalna-transformacija/>

SHPENZIMET E PRANUESHME

- Shërbimet e nënkontraktuara për zhvillim/blerje, konfigurim, vënia në funksion dhe mirëmbajtja e softuerit dhe harduerit të ri ose mbindërtim të të përdorurve në lidhje me prezantimin e zgjidhjes së propozuar për transformimin digjital;
- Furnizimi dhe/ose marrja me qira e pajisjeve dhe materialeve harxhuese për hulumtime dhe zhvillim;
- Angazhimin e ekspertëve/konsulentëve për hulumtime dhe zhvillim (p.sh. testim, vërtetim, etj.);
- Angazhimin e konsulentëve për nevoja që lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e projektit (ekspertizë për menaxhimin e inovacionit, menaxhimin financiar, mobilizimin e mjeteve, zhvillimin e biznesit, ekspertizën e marketingut për testimin e tregut dhe validimin e përdoruesve të mundshëm, çështjet ligjore, mbrojtjen e pronës intelektuale dhe të tjera);
- Përgatitjen dhe dorëzimin e një aplikacioni për patentë, mbrojtje të markës tregtare dhe/ose dizajn industrial;
- Mbështetja e zyrës dhe e biznesit në një shumë maksimale prej 5% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

PROCEDURA E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

- Kontroll administrativ i dokumenteve të dorëzuara
- Vlerësimi i parë i propozim projektit (përzgjedhja paraprake)
- Përzgjedhja e propozim projekteve më të mira (përfshirë prezantimin e propozim projekteve të parapërzgjedhura përpara Komisionit të Vlerësimit dhe Përzgjedhjes)
- Përzgjedhja e propozim projekteve më të mira
- Nënshkrimi i marrëveshjeve

KOMISIONI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

- Tre anëtarë - ekspertë të jashtëm nga fusha e sfidës
- Një anëtar - përfaqësues i organizatës partnere
- Një anëtar - përfaqësues i Fondit

KRITERET E VLERËSIMIT

- Shkalla e inovacionit
- Kapaciteti i ekipit të projektit
- Cilësia e projektit
- Potenciali i tregut
- Ndikimi



▶ Afati i aplikimit: deri më 20.03.2023, ora 14:00.

▶ Më shumë informacion në:

▶ <https://fitr.mk/digitalna-transformacija/>

▶ digitalnatransformacija@fitr.mk